




Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës  
Opstina Kamenica  
Kamenica Municipality



Nga:Shaip Surdulli,Kryetar i Komunes

Per:Kuvendin Komunal,mbledhja e datës 16.02.2010

MPL,ICO,Prokurorinë e Gjykatës , Mjetet e informimit

Lënda:Njoftim për gjendjen financiare, të stafit të administratës komunale dhe të prokurimit për vitin 2009

Data:16.02.2010

Te nderuar delegatë,

Para se të pranoj mandatin e Kryetarit te komunes,nga zgjedhjet komunale te 15 nentorit 2009,me daten 05.01.2010 iu kam drejtuar me shkrim ish Kryetarit te komunes z.Begzad Sinani që të dorëzoj me shkrim disa të dhëna për buxhetin komunal,prokurimin,stafin e administrates komunale,etj.,por nuk pranova asnjë raport me shkrim.

Pas fillimit të punës nga data 08.01.2010 kërkova dhe u furnizova me disa raporte me shkrim nga drejtoritë dhe nga disa zyre të administrates komunale për vitin 2009,si dhe raportin e auditimit të pavarur për vitin 2008.

Nga këto raporte me shkrim përshkruhet puna,por edhe parregullsi dhe keq perdorime te ligjeve,statutit komunal,rregulloreve komunale,tejkalimeve te hargjimeve te buxhetit komunal,sidomos gjate muajve tetor,nentor dhe dhjetor,tejkalime te stafit te administrates komunale,shkelje te procedurave te konkursit,etj.Ne disa raste do te angazhohen ekspert,auditori I brendshëm,auditorë te jashtem,prokuroria e gjykates ,zyra civile ndërkombëtare,etj

Po i shënoj disa nga ato parregullsi të gjetura:

1. Hargjimet financiare ndaj furnitoreve(Lista e obligimeve. financiare ndaj furnitoreve-shihni ne materialin e raportit financiar 2009).

Keto hargjime te pa paguara janë me vlerë 308.563€.Nga buxheti 2009 per mallra dhe hargjime nga zyra e kryetarit kanë qenë të parapara 25.000€,kurse jane hargjuar 125.859€ dhe kanë mbetur borxhe 149.920€.Per subvencione kanë qenë të parapara

25.000€, kurse vetëm nga zyra e Kryetarit janë shpenzuar 43.800€ dhe gjithësejt 70.245€, si dhe kanë mbetur obligime 11.845€. Në krahasim me një vit më parë, obligimet e mbetura nga viti 2008 për vitin 2009 nga zyra e Kryetarit kanë qenë 54.835€, kurse gjithësejt 76.265€.

2. Nga i tërë ish mandati 2 vjeçar për pranimin e punëtorëve nuk ka pasur konkurs, me ndonjë përjashtim 1 apo 2 rasteve. Te gjithë punëtorët janë marrë me kontratë në vepër, mandej 27 punëtorëve iu kanë vazhduar ato kontrata edhe me vite, por 16 punëtorë kishin mbetur vetëm me kontrata në vepër.  
Me vendime të datës 31.01.2010, ata 43 ish punëtorë i kam liruar nga marrëdhënja jo e rregullt e punës në administratën komunale. Këta punëtorë mund të konkurojnë në ndonjë konkurs të shpallur sipas nevojës së pozicioneve.  
Edhe në shëndetësi ka raste që janë pranuar punëtorë pa konkurs e me kontrata në vepër, të cilët së shpejti do të lirojmë nga marrëdhënja jo e rregullt e punës.
3. Disa punëtorëve ish kryetari iu kishte vazhduar kontratën e punës, kurse shumica më e madhe kanë mbetur me kontratat e punës deri në fund të vitit 2009. Janë bërë dallime me shumën e pages për të njëjten kategori të punës. Psh. zyrtar i lart i ofiqarise për punëtorin e pranuar gjatë vitit 2009 me page 214€, kurse disa punëtorë me pozitën ofiqar, të cilët kanë punuar për shumë vite më parë kanë pagën mujore 179€.
4. Numri i orëve për punën jashtë orarit të rregullt ka qenë 15.878 orë, të cilat janë paguar me vlerë 24.769€.
5. Hargjimet për karburante me vetura private me sasi prej 3.555 litra.
6. Te hyrat vetanake për vitin 2008 kanë qenë 776.384€, kurse për vitin 2009 kanë qenë 677.949€. Për shembull nga shfrytëzimi i resurseve natyrore (separacionet e zhavorit, gurethyesit) të hyrat gjatë vitit 2008 kanë qenë 17.989€, kurse gjatë vitit 2009 vetëm 5.764€. Kanë punuar 11 separacione, prej tyre 8 pa liqencë, dhe 4 pa leje të punës, kurse vetëm 1.2 ha e tokës së grupuar është mbushur. Si pasojë e gropave të mbushura me ujë nga paslufta janë mbytur 4 qytetare, kurse në vitin e kaluar një qytetar është mbytur nga shembja e dheut në një gropë të një separacioni të zhavorit të pa liqencuar dhe pa leje të punës. Obligimet të ndërmarrjeve për taksat komunale janë me vlerë 351.468,60€, kurse nga tatimi në pronë 777.842€.
7. Më 15.12.2008 është nënshkruar një Memorandum Mirëkuptimi në mes:
  1. Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural-nga Sekretari i Perhereshem, Shefki Zeqiri,
  2. Kuvendi Komunal në Kamenicë-Drejtori për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim, Xhavit Krasniqi dhe
  3. Shoqata e prodhuesve të fidaneve Leoni-Naim Krasniqi, drejtor (**djali i drejtorit** Xhavit Krasniqi).

per nje projekt per ujitje ne fshatin Dajkoc,ku Ministria ndane shumën prej 19.079,74€,kurse shoqata zotohet se do te m err pjesë në vlerë prej 2.120€.Sipas shiqimit ne vend te ngjarjes nga persona te administrates komunale,ky projekt nuk është realizuar ende plotësisht.

8.Më 19.10.2009 është nënshkruar një kontratë në mes ish kryetarit B.Sinani në emër të komunës dhe SHPK Atalanta nga Hodonoci për dhënien me qira prej 170€ në muaj lokacionin e ish tregut të kafshëve në Katushnicë.Mënyra e dhënies së kontratës pa vendim të Kuvendit Komunal dhe pa procedura të prokurimit.

9.Është nënshkruar një kontratë në mes ish kryetarit B.Sinani në emër të komunës dhe z.Mevlush Kallaba nga Koretini për dhënien me qira të lokalit të ish barnatorës shoqërore në qytet. Mënyra e dhënies së kontratës pa vendim të Kuvendit Komunal dhe pa procedura të prokurimit.

10.Zyra e prokurimit është temë e veqantë.Auditori i pavarur Deloitte ka bërë një raport në segmentet buxhetore për vitin 2008,ku për zyren e prokurimit thotë se **komuna ka dështuar në krijimin efektiv të procedurave të prokurimit.**

Ne kemi marrë një raport të zyles së prokurimit për vitin 2009 dhe auditori i brendëshëm është duke audituar në këtë zyre.Ajo që edhe qytetarët e shohin që shumë projekte janë të pa përfunduara.Psh.për projektin e ujësjellësit në Koretin është ndarë në dy faza:

1.Faza e pare,kontrata më 14.07.2009 me NNP Area Hodonoc me vlerë 97.610€ dhe aneksi 9.420€,të cilat mjete janë paguar nga komuna.

2.Faza e dytë,kontrata më 01.10.2009 me NNP Area Hodonoc me vlerë 185.634,34€,ku janë paguar 50.778€.Për këtë faze të projektit më 20.08.2009 është nënshkruar një Memorandum Mirëkuptimi në mes Ministrisë për Mjedis dhe Planifikim Hapsinor nga Ministri Jagxhilar me vlerë prej 130.000€ dhe nga komuna e Kamenicës-ish kryetari Begzad Sinani me vlerë 150.000€.

Projektet e dështuara për gjelbrimin rreth trotuarit në qytet,rruga në Hogosht kah prroi i Babanikut,etj.

Ura në Hogosht me vlerë 260.000€ e pa përfunduar nga ndërmarrja Varna,ku janë ndërprerë punimet dhe gropat e thella anëve paraqesin rrezik të vazhdueshëm për jetrat e qytetarëve,deri sa ish kryetari në prag të zgjedhjeve për balotazhë bënë inaugurimin e urës së papërfunduar.

11.Asgjë nuk është ndërmarrë për rregullimin e statusit të kiosqeve në qytet dhe për inkasimin e pagesave nga mbi ndertimet te qendra tregtare.



Kryetari i Komunës  
Shaip Surdulli

*Shaip*